

VENDIM
Nr. 412, datë 21.5.2013

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES DHE TË EMËRIMIT TË DREJTORIT
TË PËRGJITHSHËM TË INSTITUTIT TË STATISTIKAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 9 të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikave zyrtare”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

- a) “Ligji i statistikave zyrtare”, ligji nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikave zyrtare”, i ndryshuar;
- b) “INSTAT”, Instituti i Statistikave;
- c) “Drejtori i përgjithshëm”, drejtori i përgjithshëm i Institutit të Statistikave;
- ç) “Këshilli”, Këshilli i Statistikave.

2. Përcaktimi i procedurave dhe i kriterëve të përzgjedhjes dhe rekrutimit të drejtorit të përgjithshëm, ka për qëllim të sigurojë drejtimin e Institutit të Statistikave në mënyrë profesionale, të pavarur dhe me integritet të lartë moral, nëpërmjet kryerjes së procedurave transparente përzgjedhëse, duke u mbështetur në kriteret tërësisht profesionale për të përballuar detyrat e përcaktuara në ligjin e statistikave zyrtare.

3. Përzgjedhja e kandidatëve për drejtorin e përgjithshëm kryhet nëpërmjet zbatimit të procedurës së hapur të rekrutimit nga Këshilli i Statistikave, bazuar në pikën 3 të nenit 9 të ligjit të statistikave zyrtare, të ndryshuar.

KREU II
SHPLLJA E KONKURRIMIT TË KANDIDATËVE

1. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga lirimi i drejtorit të përgjithshëm, Këshilli, në zbatim të pikës 3 të nenit 9 të ligjit të statistikave zyrtare, përgatit dokumentacionin dhe shpall në media vendin e lirë për titullarin e institucionit.

2. Këshilli i Statistikave, me shpenzimet e INSTAT-it, boton shpalljen e konkurrimit për vendin e lirë në dy gazeta me qarkullim më të madh kombëtar dhe në faqen elektronike të INSTAT-it. Botimi bëhet, të paktën, 20 (njëzet) ditë para datës së caktuar për zhvillimin e testimit, tri ditë me radhë.

3. Shpallja e konkurrimit për vendin e lirë përmban këto të dhëna:

- a) Një përshkrim të shkurtër të natyrës së punës dhe funksionit që do të mbulojë;
- b) Kërkesat për pranimin e kandidatëve;
- c) Listën e dokumenteve që duhet të paraqiten, vendin ku do të paraqiten dhe afatin deri kur do të paraqiten dokumentet;
- ç) Mënyrën dhe kohën kur do të shpallet lista e kandidatëve që do të kualifikohen për fazën e testimit;
- d) Datën dhe vendin e zhvillimit të testimit;
- dh) Fushën e njohurive që do të testohen, llojet e testeve, si dhe bibliografinë përkatëse.

4. Krahas kërkesave të përgjithshme, të parashikuara në pikën 3/1 të nenit 9 të ligjit të statistikave zyrtare, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kërkesat e përgjithshme për t’u punësuar në shërbimin civil, sipas nenit 12 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

5. Këshilli mund të përcaktojë kërkesa të veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët, fushat për të cilat do të testohen kandidatët dhe datën kur do të zhvillohet konkurrimi. Përcaktimi i këtyre kërkesave mbështetet në specifikën e detyrës që do të mbulojë drejtori i përgjithshëm sipas ligjit të statistikave zyrtare.

KREU III
PROCEDURA E PËRZGJEDHJES DHE E TESTIMIT TË KANDIDATËVE

1. Procedura e përzgjedhjes dhe e testimit të kandidatëve përfshin dy faza:

a) Faza e përzgjedhjes së kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen e konkurrimit, gjatë së cilës shqyrtohet dokumentacioni i kandidatëve që kanë aplikuar për këtë pozicion pune. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Këshilli harton listën e kandidatëve të kualifikuar për fazën e dytë, brenda 3 (tri) ditëve pune nga data përfundimtare për paraqitjen e dokumenteve nga kandidatët.

b) Faza e testimit, gjatë së cilës kryhet intervistimi i kandidatëve për të vlerësuar njohuritë që zotërojnë kandidatët në fushën e statistikave, filozofinë drejtuese të tyre, strategjitë dhe risitë që mund të sjellin gjatë zbatimit të këtij funksioni drejtues. Testimi i kandidatëve kryhet jo më parë se 5 (pesë) ditë nga data e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar për këtë fazë.

2. Në fazën e përzgjedhjes së kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen e konkurrimit veprohet si më poshtë vijon:

a) Këshilli i Statistikave bën verifikimin paraprak të kandidatëve, të cilët, në bazë të fotokopjeve të dokumenteve të paraqitura, përmbushin kërkesat e përcaktuara në shpalljen e konkursit;

b) Për garantimin e paanshmërisë së veprimtarisë së anëtarëve të Këshillit të Statistikave, zbatohen nenet nga 37 deri 43 të Kodit të Procedurave Administrative. Në rast të konstatimit të rasteve të parashikuara në këto nene, anëtarë në fjalë i Këshillit të Statistikave jep dorëheqjen nga procesi i vlerësimit të kandidatëve dhe nuk përfshihet në asnjë hap të mëtejshëm të këtij procesi;

c) Kandidatët, që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe që do të marrin pjesë në testim, renditen sipas rendit alfabetik. Personat, që nuk plotësojnë kërkesat e sipërpërmendura renditen në një tjetër listë, ku tregohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Listat e mësipërme shpallen në kohën e parashikuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij kreu;

ç) Brenda dy ditëve nga shpallja e listave, personat e interesuar mund të paraqesin ankesat në Këshillin e Statistikave. Ankesat shqyrtohen dhe zgjidhen nga Këshilli brenda 3 (tri) ditëve nga depozitimi i tyre. Dokumentacioni i shqyrtimit të ankesave dhe mënyrës së zgjidhjes së tyre është pjesë e dokumentacionit të testimit që i dorëzohet Kryeministrit për caktimin e kandidatit fitues sipas pikës 2 të kreut V të këtij vendimi.

3. Për fazën e testimit veprohet si më poshtë vijon:

a) Testimi zhvillohet me gojë në ditën dhe në vendin e caktuar në shpalljen e konkursit;

b) Këshilli i Statistikave përcakton subjektet e testimit në këto fusha:

i) njohuri në fushën e statistikave dhe përmbajtjen e programit pesëvjeçar të statistikave zyrtare;

ii) njohuri për Kushtetutën, Kodin e Procedurave Administrative dhe për legjislationin dhe funksionimin e administratës publike;

iii) njohuri për legjislationin mbi të cilin mbështetet funksionimi i sistemit kombëtar statistikor;

iv) filozofinë drejtuese;

v) strategjitë dhe risitë që mund të sjellin gjatë zbatimit të këtij funksioni drejtues.

c) Lidhur me përcaktimet e nënndarjeve “iv” e “v” të shkronjës “b” të kësaj pike, kandidatët mund t’i paraqesin Këshillit edhe një prezantim të shkurtër në format *Power Point*.

KREU IV VLERËSIMI I KANDIDATËVE

1. Këshilli i merr vendimet në prani të të gjithë anëtarëve të tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara në shkronjën “b” të pikës 2 të këtij kreu.

2. Këshilli shqyrton plotësimin e kriterëve të parashikuara në pikën 2 të kreut III të këtij vendimi dhe vlerëson kandidatët e klasifikuar në bazë të treguesve të mëposhtëm:

a) Rezultateve të studimeve universitare apo pasuniversitare;

b) Përvojave të mëparshme në punë që lidhen me pozicionin;

c) Vlerësimeve të punës;

ç) Trajnimeve apo specializimeve të ndryshme;

d) Të dhënave për studimet e kryera apo botimet në fusha që i shërbejnë pozicionit;

dh) Të dhënave për integritetin moral;

e) Të dhënave për masa disiplinore;

ë) Të dhënave për aftësi të spikatura organizative dhe menaxhuese;

f) Çdo të dhënë tjetër që tregon përparësi të kandidatit përkatës ndaj kandidatëve të tjerë.

3. Pikëzimi i testimit bëhet sipas vlerësimit me pikë nga 1 në 10 për çdo kriter, në përputhje me pikën

2 të këtij kreu, dhe për çdo pyetje drejtuar kandidatëve gjatë fazës së testimit. Pyetjet duhet të jenë të barabarta dhe të së njëjtës natyrë për të gjithë kandidatët.

4. Këshilli përgatit një listë të kandidatëve, sipas rezultateve të arritura, duke filluar nga ai me më shumë pikë. Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta, renditja bëhet sipas rezultateve të hedhjes në short. Lista e renditjes së kandidatëve u dorëzohet këtyre jo më vonë se 2 (dy) ditë nga data e zhvillimit të testimit.

5. Këshilli i propozon Kryeministrit jo më shumë se tri nga kandidaturat e paraqitura, të cilat plotësojnë kërkesat e mësipërme dhe krijojnë bindjen e Këshillit për aftësinë e tyre profesionale në fushën e prodhimit statistikor dhe drejtimit të një organizate.

6. Kryeministri zgjedh njërin prej tre kandidatëve brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kandidaturave të propozuara nga Këshilli i Statistikave. Për këtë qëllim, Kryeministri zhvillon paraprakisht një bashkëbisedim me secilin nga tre kandidatët e propozuar nga Këshilli.

7. Këshilli, brenda 4 (katër) ditëve nga miratimi i Kryeministrit, shpall kandidatin fitues në dy gazetatat me qarkullim më të madh kombëtar.

KREU V DISPOZITA TË TJERA DHE KALIMTARE

1. Këshilli i Statistikave mban dokumentacionin e procedurës së rekrutimit dhe një kopje të dosjes së aplikantëve në arkivin e INSTAT-it.

2. Propozimi i kandidaturave Kryeministrit shoqërohet me dokumentacionin e plotë administrativ të rekrutimit dhe një kopje të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët aplikantë të propozuar.

3. Për përmbushjen e detyrave të tij në zbatim të ligjit për statistikat zyrtare dhe të këtij vendimi, Këshilli i Statistikave asistohet nga sekretariati i Këshillit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve pranë INSTAT-it.

4. Ngarkohet Këshilli i Statistikave, që, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të fillojë procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për pozicionin e drejtorit të përgjithshëm të INSTAT-it.

5. Drejtori i përgjithshëm aktual i INSTAT-it qëndron në këtë funksion deri në përzgjedhjen dhe emërimin e kandidatit fitues nga Kryeministri.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha